



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery		15-12-2023	3 viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCIL	7506	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1427/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1427/2023, të datës 21.11.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit, Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.1427/2023, e datës 21.11.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, (tutje referuar vetëm ankuese), e punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në pozitën e punës "Zyrtar për mbrojtje dhe shfrytëzim të kullosave" në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, më datë 21.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me shenjën A.nr.1427/2023, kundër përgjigjes në kërkesë me nr.prot.01-120/04-0072568-2/23 me pretendimin ankimor se është kategorizue në profesional 2 përkundër që do të duhej të kategorizohej si specialiste nga se i plotësoj kriteret profesionale nga se jamë Master i Shkencave në Inxhinieri dhe Teknologji Informative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më

datë 22.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Kjo e fundit, më datë 01.12.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e parakohshme, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit , sipas akt emërimit me nr.01-112-69254 të datës 05.08.2015 , rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën "Zyrtar për mbrojtje dhe shfrytëzim të kullosave" në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja ka pasur gradën shtatë (7) , sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në *Profesional 2*.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë sistemimit të fundit kam mbetur në nivelin me të ulët të pagës. Kërkon që ti njihet e drejta e kompensimit për punën që kryen, duke pas parasysh kualifikimet profesionale të ankueses, andaj kërkon që të bëhet klasifikimi i ri për këtë pozitë ashtu që kjo pozitë të klasifikohet nga kategoria profesional 2 në specialiste .

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, i cili afat me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr.17/162 të datës 27.09.2023 është ndryshuar me që rast Institucionet kanë obligim ligjorë që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës deri më datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, përkundër që e njëjta atakon përgjigjen në kërkesë të datës 03.10.2023 por se përmbajtja e saj ndërliidhet me klasifikimin e vendeve të punës dhe poashtu edhe ankesa objekt ka klasifikimin e pozitës dhe këtë përgjigje të apostrofuar si më lartë, andaj edhe kolegji nuk u lëshue në shqyrtim të kësaj kërkesë nga arsyeja e mësipërme, nga se çështja kryesore është klasifikimi i pozitës, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1427/2023, datë 15/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK-së